



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

SUKSESET QË SPIKATËN GJASHTËMUIORIN E PARE TË VITIT 2020



## INFORMATË RRETH INVESTIMEVE PUBLIKE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Dërgojem një informacion përmes këtij dokumenti që ka si qëndër qëndrueshme informacionet e rreth investimeve publike që janë realizuar në komunën e Rahovecit. Në këtë dokument do të përfshihen të gjitha projekte që kanë qenë realizuar në komunë, siç janë investimet e reja, modernizimi i infrastrukturave, ndërtimi i objekteve publike, etj. Kjo është një informacion i rëndësishëm për qytetarët e Rahovecit, pasqyronin qëndrueshmen e zhvillimit të komunës së Rahovecit.

- Smajl Latifi -

Kryetar i Komunës së Rahovecit



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
RAHOVEC / RAHOVECOPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PËRZGJEDHJE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabinet i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 918 Nr. ifaq/Br str./No.pg 92

Data/Datum/Date 26/06/2020

RAHOVEC / ORAHOVAC



## PËRMBAJTJA

HYRJE ..... 3

Sukseset që spikatën periudhën e gjashtëmujorit të parë për vitin 2020: ..... 4

PËRFUNDIM ..... 18

## HYRJE

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Kemi kënaqësinë të paraqesim para jush një informatë për punët, angazhimet dhe arritjet e komunës së Rahovecit për periudhën: janar- qershori 2020, si dhe ecurinë e implementimit të projekteve kapitale në komunën e Rahovecit përgjatë kësaj periudhe.

Sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, besojmë se suksesi ynë më i madh i përbashkët ka qenë tejkalimi i sfidave e barrierave në favor të qytetarit Rahovecas, me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim dhe punë të palodhur ne kemi arritur që në këtë periudhë që po e lëmë pas të realizojmë me sukses një sërë projektesh që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Rahovecit, edhe përkundër situatës pas shfaqjes së pandemisë COVID-19.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale.

Informata që po e prezantojmë sot përfshinë detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë.

**Vërejtje:** *Informata mbi masat dhe veprimet e Shtabit të Posacëm Emergjent në Komunën e Rahovecit për parandalimin e virusit Korona, është e publikuar veçmas me të dhëna specifike dhe detaje mbi gjendjen aktuale në komunën e Rahovecit, pas shfaqjes së pandemisë COVID-19.*

## Sukseset që spikatën periudhën e gjashtëmujorit të parë për vitin 2020:



Komuna e Rahovecit u rendit e para nga 38 komunat e Kosovës nga Institut Demokratik i Kosovës KDI për transparencë dhe llogaridhënie komunale, në kuadër të Transparometrit komunal, i cili u zhvillua për vitin 2019 në të gjitha komunat e Kosovës.

Është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për qytetarët e komunës së Rahovecit.



### Është finalizuar synimi 19 vjeçar-

Licencimi i Zonës Ekonomike- Parkut Industrial në komunën e Rahovecit, me krijimin e kësaj zone kemi për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investitorëve të huaj dhe vendor, bizneseve vendore të cilat do të vendosen në këtë zonë, duke mundësuar këshfu edhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Kemi përmbyllur projektin e pompave të ujit në fshatin Pastasel, uji është testuar dhe ka ardhur deri në rezervuarin shpërndarës, i është dërguar kërkesa KRU "Gjakova" për pranimin e punëve dhe për mirëmbajtje, ku dhe kemi përvuara së bashku me zyrtarë të ujësjellësit ujin e pijshëm.



Bashkë me UN-Habitat kemi vazhduar procesin e planifikimit dhe shpaljues së konkursit ndërkombëtar për hartimin e projektit ideor te sheshit qendror te qytetit ne Rahovec. Sipas marrëveshjes që kemi lidhur me këtë organizatzë të specializuar të Kombeve të Bashkuara, planifikuesit urban janë vendosur në zyrat e Drejtorisë së Urbanizimit dhe në bashkëpunim me ta kemi perfunduar një pjesë të konsiderusheme të punëve të parapara, janë përfunduar matjet gjeodezike, është formuar ekipi komunal për planifikim, me vendim të Kryetarit, janë mbledhur të dhëna të pjesës ku planifikohet të ndërtohet sheshi, janë marrë informata gjeodezike dhe kadastrale, janë shpallur disa pjesë me vendim te Kuvendit Komunal, në interes publik për ndërtimin e sheshit, është bërë plani për mbajtjen e diskutimeve publike në fund të marsit, mirëpo për shkak të masave të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen nga Virusi Corona, janë shtyrë në një afat të papercaktuar diskutimet me qytetarë.



Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Rahovecit, miratuam BUXHETIN, për vitin fiskal 2020, si rrjedhojë ky buxhet është mundësi reale për vazhdimin e përpjekjeve për përm bushjen e planit tonë për vitin 2020, në shërbim të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Buxheti i përgjithshëm për vitin 2020 është 14,735,841.00 €, ku nga të hyrat vetanake të planifikuara kemi: 1,156,841.00 €. Për: Paga dhe Mëditje janë: 8,644,220.00 €, Mallra dhe Shërbime: 1,594,330.00 €, Shpenzimet komunale: 280,500.00 €. Subvencione dhe Transfere: 311,000.00 €, Investime kapitale 3,905,770.00 €.



Qysh në fillim të vitit kanë rifilluar punimet në projektet ku kemi kontratë me Operatorët Ekonomik. Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara pas shpaljues së rezultateve nga komisioni.



Komuna e Rahovecit, përkatësisht drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka bërë shpërndarjen e mekanizmave bujqësor: 301 motokultivatorë (benasë). Nga kjo fazë dhe nga fazat e tjera të shpërndarjes kanë përfituar motokultivatorë, gjithsej 361 fermerë, të cilët do ta kenë më të lehtë të fillojnë punët e tyre përgatitore për këtë sezonë dhe të kenë prodhimtari cilësore. Përkujtojmë faktin se, në 6 faza të shpërndarjes, për 12 lloje të pajisjeve, veglave dhe të mekanizmit bujqësor, kanë përfituar 812 fermerë.

Është nënshkruar, Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Projektit "Subvencionet për Eficiencë të Energjisë në Kosovë-SEEK" dhe Komunës së Rahovecit. Projekti ka përqëllim të zvogëlojë konsumin e energjisë elektrike në sektorin e banimit duke ndarë subvencione dhe stimuj të tjerë ekonomik për njësitë e banimit që të investojnë në masa të Eficiencës së Energjisë dhe në Burime të Ripërtërishme të Energjisë, nëpërmjet pakos ndërhyrëse Renovimet për Eficiencë në Njesitë e Banimit.



Në ndërtim e sipërm dy segmente rrugore, arterie të rëndësishme për qytetarët tanël Rruga Rahovec-Brestoc-Fortesë dhe Rruga Xerxë-Sapniq-Ratkoc!





Vazhdon ndërtimi i çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe.

Ndërtimi i objektit të ri të shkollës "Liria" në Fortesë dhe sallës së edukatës fizike.



Disa nga projektet në implementim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, të paraqitura me fotografi:Ndërtimi i trotuarëve në Ratkoc dhe ndërtimi i rrjetit të ujërave fekale në Dobidol.



Ka përfunduar hapja dhe rregullimi i rrugës fushore që lidh fshatrat Drenoc dhe Nushpal, hapja e kësaj rruge përfshinë mbi 100 ha me vreshta dhe toka tjera të punueshme.

Rregullimi i rrugëve fushore ka rëndësi të madhe për fermerët e komunës sonë. Shumë toka të punueshme kishin qasje të vështirë për mungesë të rrugëve, ku si pasojë e kësaj për shumë vite kishin mbetur djerrinë. Aktualisht punimet janë duke u zhvilluar në: Dejnë, Dobidol, Vrajakë, Zoqisht dhe Hoçë të Vogël.



Vazhdojnë punimet në ndërtimin e rrjetëve të ri të kanalizimit në disa vendbanime: Fortesë, Krushë e Madhe, Opterushë dhe Dobidol. Do të vazhdojmë edhe në vendbanime tjera sipas projektit dhe kërkeseve të qytetarëve!



Vazhdojnë punimet për ndërtimin e shtegut të ecjes "LULET E MARSIT", në Krushë të Madhe. Shtegu do të jetë i gjatë 1050 metra dhe qytetarët e Krushës së Madhe mund ta shfrytëzojnë për ecje, vrapim apo qëndrim ditor

**Me ballin drejt Pashtrikut, Kulla e dy heronjve të kombit, Toni e Mici, po merr formë. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të kombit dhe UÇK-së!**



**Vazhdojnë punimet në kanalin e kullimit të tokave bujqësore në Malësi të Vogël dhe Ratkoc**



**Projekti i ndërtimit të tetë parqeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe në këtë fillimvit, ka vazhduar ndërtimi i parkut ne Sopniq, në Pataqan të Poshtëm, në Malësi të Vogël, në Dobidol, Celinë, Zogisht dhe ndërtimi i oborrit të shtëpisë së fshatit në Senoc. Do të vazhdohet edhe me ndërtimin e parkut në Ratkoc.**



Është nënshkruar marrëveshjea e bashkëpunimit për Grantin e Performancës që si komunë e kemi fituar si rezultat i angazhimit, përkushtimit dhe efikasitetit të ekzekutivit komunal në Rahovec për qeverisje të mirë e transparente. Granti në vlerë prej: 255.731€, do të përdoret për realizimin e projekteve kapitale për këtë vit, duke përfshirë ndërtimin e rrugëve si dhe rregullimin e përrenjeve.



Rrugët vreshtare për ditë e më shumë po rregullohen! Kanë filluar punimet në segmentin rrugor: Nushpallë - Vrajakë - Ratkoc i gjatë 4,600 metra. Ky investim është duke u financuar nga Ministria e Bujqësisë.


Edhe në Senoc rrugët fushore janë duke shkuar drejt përfundimit.



Kanë filluar punimet për ndërtimin e rrugës në relacionin: Rahovec - Pataqan i Ulët, projekt ky i një rëndësie të veçantë sa i përket infrastrukturës rrugore, sepse krijon kushte më të mira të qarkullimit dhe lëvizjes së qytetarëve.



**Janë duke vazhduar me intensitet të shtuar, punimet në Shtëpinë e Kulturës në Ratkoc, besojmë që shumë shpejtë do përfundohet edhe riparimi i këtij objekti, i cili është shumë i rëndësishëm përfaktin se një gjë e tillë është e nevojshme për të rinjtë tanë, sidomos për komunitetin artistik.**



**Ka filluar restaurimi i Mullirit të familjes Hoxha, i cili është i vjetër afro 300 vite, dhe njihet si "Mulliri i Hoxhajve", i njëjtë ka shërbyer për nevojat e familjes, si dhe ka qenë funksional para shumë vitesh. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe vlerat që i posedojnë monumente të tillë të cilët nuk janë të paktë në komunën e Rahovecit, ne si institucion kemi marr një hap të rëndësishëm drejt ruajtjes dhe mbrojtjes së monumenteve me rëndësi të veçantë historike, krahas restaurimeve të cilat janë bërë, ndër ta është dhe ky mulli i cili ka filluar të restaurohet.**




**Ka vazhduar restaurimi i "Bunarit të Madh" në fshatin Ratkoc, i cili për banorët e këtij vendi ka një rëndësi të veçantë historike.**

**Me intensitet të lartë, kanë vazhduar edhe punimet në fushën sportive në fshatin Dejnë.**



Punimet të cilat janë duke u zhvilluar ne vendin e quajtur "Tregu i Rushit" po i japin atij një pamje të re dhe të përshtatshme për të plasuar produktet për shitje.



Sinalizimi i rrugës në pikën turistike, në drejtim te Maja e Shkodranit ne Rahovec



Ndërtimi i objektit së çerdhes për fëmijë që po ndërtohet në Ratkoc.



Edhe në objektin e ri të shkollës "Sadedin Hajda" në qytet, këto ditë është rritur intensiteti i punimeve. Po vazhdon fasadimi i jashtëm i mureve të objektit.

Vazhdon mirëmbajtja e hapësirave publike, në: Mirëmbajtjen e varrezave, lapidarëve, trotuareve,



Jemi në përfundim të projektit të ndriçimit publik në fshatin Malësi e Vogël.




Kanë filluar punimet në dy segmente rrugore në qytetin e Rahovecit:  
Segmenti i rrugës "Gëzim Mullabazi" do të ketë trajtim të ujërave atmosferik dhe instalime tjera, më pastaj do të asfaltohet dhe segmenti i rrugës "Xhafer Nurkasa" do të asfaltohet dhe do të bëhet orientimi me sinjalizim, për rrugë njëkahore dhe do të ketë parkingje për vetura

Janë nënshkruar dy marrëveshje të mirëkuptimit me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (MZHR). Sipas këtyre marrëveshjeve, MZHR bashkë me Komunën e Rahovecit do të financojnë dy projekte, konkretisht: projektin: "Renovimi i Stacionit të autobusëve dhe kabinave inovative" në vlerën: 100.000 euro, si dhe projektin: "Ndërtimi i rrugës në fshatin Zaqisht", në vlerën: 30.000 euro.




Vazhdojnë punimet në rrugen Rahovec-Brestoc-Fortesë, është duke u bërë muri mbrojtës në këtë segment.



Pamjet e ndërtimit të rrugës rajonale R-110, Rahovec-Malishevë.

Zgjerimi i rrugës në segmentin Rahovec-Malishevë afër tranzitit, ndërtimi i murit mbrojtës në anën e djathtë të rrugës, segmenti me 3 korsi, Loto III.

Ndërtimi i QKMF-së, faza e dytë dhe përfundimtare, projekti deri më tani ka arritur në 80%, besojmë se deri në muajin korrik, shpejtë do të përfundojmë objektin e QKMF-së dhe Emergjencës.



**10 MIJË DRUNJ PËR RAHOVECIN - Një projekt serioz që do t'ia ndryshojë pamjen për të mirë komunës së Rahovecit, ka nisur sot. Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka nisur së zbatuari projektin për mbjelljen e drunjve të llojeve të ndryshme, si Rrap, Bli, Catalpa etj, sipas së cilit parashihet mbjellja e mbi 10 mijë drunjve në tërë territorin e komunës sonë.**

Kanë vazhduar me intensitet të shtuar punimet në ndërtimin e objektit të çerdhes për fëmijë në Xërxe.




Lapidari në oborrin e shkollës fillore në fshatin Guri i Kuq kushtuar 17 martirëve të rënë me 31 mars 1999. Projekti i lapidarit është realizuar në bashkëfinancim ndërmjet Komunës së Rahovecit dhe banorëve të fshatit. Përvimi zyrtar do të bëhet më 14 qershor, në Ditën e Çlirimtës së Rahovecit.



Ndërtimi i trotuarëve në Opterushë. Punimet janë duke vazhduar nga rruga Rajonale Rahovec-Suharekë në drejtim të qendrës së fshatit.

Së shpejti do të fillojnë punimet në realizimin e projektit të eficiencës së energjisë në objektin e Shfmu "Nesimi Elshani" në Nagac, ky është njëri prej 4 projekteve të këruara dhe të fituara që 2 vite nga komuna Jonë për zbatimin e masave të eficiencës së energjisë në objekte shkollore, i cili më në fund po fillon të bëhet realitet! Në kuadër të këtij projekti do të bëhet instalimi i ngrohjes qendrore, rregullimi i ndriçimit të brendshëm, ndërrimi dhe riparimi i dyerve dhe dritareve dhe termoizolimi i kulmit.





Fermerëve të Malësisë së Vogël po iu krjohet qasje më e lehtë dhe më e shpejtë në tokat e tyre të punës, me investimet e Komunës së Rahovecit në projektin e rregullimit të rrugëve fushore.



Traseja e ndërtimit të rrugëve në Rahovec! Njëri prej segmenteve të infrastrukturës rrugore në trekëndshin Xërxe-Sapniq-Ratkoc!

Rruja do të ketë edhe elementet përcjellëse, si; asfaltimi i rrugës, shtegu, trotuare dhe ndriçim publik.

Një prej metodave të depërtimit nëntokësor të gypit të kanalizimit. Punimet në infrastrukturë nuk kanë të ndalur në komunën e Rahovecit.



Zgjerimi dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Dobidol.



Në Shkollën e Mesme Profesionale "Selajdin Mullabazi-Mici" përvruam 3 kabinete të pajisura për drejtimet profesionale, investime këto të DKA-së:

- Kabinetin e shkencave juridike
- Kabinetin e Teknologjisë Informative
- Kabinetin e Makinerisë



Pas zbatimit me përpikmëri të projektit të DKA-së me Bankën Botërore, Shkolla "Hamëz Thaçi" në Xërxë është pajisur me kabinetin e teknologjisë informative me 10 kompjuterë, videoprojektor dhe pajisje përcjellëse.

Kompleksi përkujtimor në  
Kodër të Gradishit.



## PËRFUNDIM

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendoror është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit përmes këtij dokumenti ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njojin e vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësítë e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjeter përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gjelqojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, 26 qershor 2020

